



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primljeno / Prodato Received / Delivety	13. 01	2021	1	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKANDSHK	129/2021		1/4	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.379/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabanianëtarë, Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.379/2020 të datës 30.11.2020 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga "Bajram Kelmendi" ND 54/24, në Prishtinë, kundër Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike „transfer“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 13.01.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.379/2020 të datës 30.11.2020, e parashtruar nga ankuesja**

**II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër Nr. 14-112/02-45957/19 i datës 27.02.2019, i Kryetarit të Komunës së Prishtinës.**

**III. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Prishtinës që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) nga dita e pranimit të tij, duke e kthyer ankuesen sipas Akt Emërimit të datës 01.02.2017 në pozitën "Asistente Administrative 4", në kuadër të Drejtorisë për Kadastër në Komunën e Prishtinës.**

**IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

**Arsyetim**

Ankuesja e punësuar në Komunën e Prishtinës sipas Akt Emërimit të datës 01.02.2017, me numër 01 nr.112-973, në pozitën "Asistente Administrative 4", në Drejtorinë për Kadastër në Komunën e Prishtinës, me vendim me numër 14-112/02-45957/19 të datës 27.02.2019, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës është transferuar përkohësisht nga pozita "Asistente Administrative 4", në Drejtorinë për Kadastër në pozitën "Zyrtare për Shërbim me

Qytetar", në kuadër të Drejtorisë së Administratës për një periudhë 12 mujore gjegjësisht nga data 01.03.2019 deri me date 28.02.2020.

Ankuesja, pas skadimit të transferit me datën 02.03.2020, me kërkesë përmes e-mailit zyrtar i 'u është drejtuar Drejtoreshës së Administratës së Komunës së Prishtinës ku ka kërkuar qe pasi ka skaduar afati i transferit të kthehet në pozitën ku ka qenë me herët. Po ashtu ankuesja disa here radhazi përmes e-mailave zyrtar ka kërkuar që të kthehet në pozitën ku ka punuar para transferit, mirëpo asnjëherë nuk ka marrë përgjigje nga menaxhmenti i Komunës se Prishtinës .

Ankuesja e pakënaqur me mos kthimin në vendin e punës pas përfundimit të afatit të transferit të përkohshëm me datën 17.09.2020, ka parashtruar ankesë në Drejtorinë e Administratës të Komunës së Prishtinës, mirëpo Drejtorja e Administratës së Komunës së Prishtinës nuk i ka kthyer përgjigjeje ankueses.

Ankuesja e pakënaqur me mos përgjigjen nga Drejtorja e Administratës së Komunës së Prishtinës me datën 30.11.2020, ka parashtruar ankesë me numër protokoli 2839/2020, kundër heshtjes administrative në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.12.2020, e ka proceduar tek Komuna e Prishtinës kërkesën për përgjigje në ankesë, ndërsa Komuna e Prishtinës, nuk ka kthyer përgjigjeje edhe pas disa përpjekjeve të berë nga Këshilli të dërguara përmes e-mailit mirëpo deri me sot Komuna e Prishtinës nuk ka përcjell dokumentacionin e kërkuar nga ana jonë.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoli 2839/2020 të datës 30.11.2020 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i datës 27.02.2019 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Propozim për transferim te shërbyesit civil i datës 27.02.2019; Ankesë e datës 17.09.2020 e parashtruar ne Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Formular i ankesës i datës 17.10.2020; Ankesë e datës 29.05.2020 drejtuar Drejtoreshës se Administratës se Komunës se Prishtinës; Kontrate e datës 01.01.2012; Kontrate e datës 01.12.2010; Kontratë e datës 12.02.2010; Kërkesë përmes e-mailit zyrtar të datës 02.12.2019; Kërkesë përmes e-mailit zyrtar te datës02.04.2019; Kërkesë përmes e-mailit zyrtar të datës 02.03.2020; Formulari i ankesës i datës 28.06.2020; Akt emërim i datës 01.02.2017 i ankueses; Akt emërim i datës 06.07.2012 i ankueses; Prova me certifikata dhe te diplomës te ankueses të bashkangjitura ne lenden e ankesës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të ofruara nga ankuesja, ka konstatuar se ankesa e ankueses Fetije Rizani, është e bazuar *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se me Vendimin e Kryetarit te Komunës se Prishtinës të datës 27.02.2019, ankuesja është transferuar përkohësisht nga pozita e "Asistentes Administrative 4", në kuadër të Drejtorisë për Kadastër, në pozitën "Zyrtare për Shërbim me



Qytetar", në kuadër të Drejtorisë së Administratës me propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Administratës Muhedin Nushi të datës 27.02.2019, për periudhën prej datës 01.03.2019 deri me datën 28.02.2020, si nevojë e domosdoshme që është paraqitur gjate procesit të punës në këtë drejtori.


Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka konstatuar se ankuesja e ka ushtruar pozitën e "Zyrtares për Shërbim me Qytetar" pranë Drejtorisë për Administratë në Komunën e Prishtinës, për periudhën e paraparë sipas vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, mirëpo që e njëjta pas përfundimit të afatit të transferimit nuk është kthyer në pozitën e mëparshme siç ka qenë sipas Akt emërimit të datës 01.02.2017, e që është në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 2 të Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil i cili përcakton se: *"Transferimi i përkohshëm mund të zgjasë deri në dymbëdhjetë (12) muaj"*, andaj që nga data 28.02.2020, është plotësuar kushti i transferimit të përkohshëm për periudhën e caktuar dhe sipas Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil ankuesja është dashur të kthehet në pozitën e mëparshme ku ka qenë e sistemuar para transferimit të përkohshëm sipas Akt Emërimit të datës 01.02.2017 në pozitën "Asistente Administrative 4", ashtu siç përcaktohet me nenin 5 paragrafin 3 të Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil ku thuhet se; *"Pas kalimit të periudhës së transferimit të përkohshëm, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme"*.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se organi i punësimit Komuna e Prishtinës, është e obliguar që të zbatojë Vendimin e Këshillit, ankuesen ta kthejë, në pozitën "Asistente Administrative 4", në sipas ndryshimit Akt Emërimit të datës 01.02.2017 me numër 01 nr.112-973 në Drejtorinë për Kadastër në Komunën e Prishtinës, dhe të vepronte në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komuna e Prishtinës, ka vepruar në kundërshtim me nenin 25, paragrafi 1 dhe 2, të Ligji nr. 06/1 -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se; *1. Këshilli bashkëpunon me institucionet e administratës publike për të kryer funksionet e tij në përputhje me këtë ligj. 2. Institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, si dhe çdo funksionar publik ose nëpunës civil, që ka kompetenca në administrimin e shërbimit civil, apo ka informacion në këtë fushë, janë të obliguar të bashkëpunojnë me Këshillin"* sepse në rastin konkret Sekretariati i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.12.2020 dhe 08.01.2021 e ka proceduar tek Komuna e Prishtinës, kërkesën për përgjigje në ankesë, ndërsa Komuna e Prishtinës nuk e ka dërguar përgjigjen në ankese respektivisht nuk ka përcjell dokumentacionin e kërkuar nga ana jonë.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.





**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.379/2020

**Ardita Perenku-SHYTI**

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Malsore Gashi-BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

